



REPUBLIKA E MAQEDONI SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Nr. 03-358

17.11.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 14 paragrafi (1) të Ligjit për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13 dhe 13/14), pika 3 nënparagrafi 2 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.03-3865 /1, datë 26.10.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 37-të mbajtur më 16.11.2023, në pajtim me Konkluzionin nr. 02-4225/6 datë 16.11.2023 miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria për prodhim, qarkullim, dhe shërbime REPRO PRINT SHPKNJP eksport-import Shkup, botues i "Nova Makedonija", për shkeljen e kryer të nenit 14 paragrafi (1) të Ligjit për media, të mënyrës që në botimin nr.25952 të "Nova" Makedonija" të datës 20 tetorit 2023, në vend që të shpallet numri i saktë i kopjeve të shtypura, në impresium është thënë se botimi është shtypur "në tirazh deri në 3500 kopje".

2. Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.03-3865 /1 datë 26.10.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1 .

3. URDHËROHET Shoqëria për prodhim,qarkullim dhe shërbime REPRO PRINT SHPKNJP eksport - import Shkup, botues i "Nova Makedonija", në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, që të harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për Media.

4. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

A r s y e t i m

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia), në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për Media (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrjen administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i respektimit të punës së tyre me detyrimet nga nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masën - vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur është kryer shkelje, konstatim të mosrespektimit, cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të ligjit, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent mund t'i ndërmarrë, të cilat janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen gjithashtu dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas neni 14 paragrafi (1) nga LM, botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartës individualisht të përmbajtjes (për shembull mostër nga media e shtypur dhe emisioni televiziv) të ofrojë publikimin e të dhënave në vijim: emrin dhe adresë të selisë dhe redaksisë së botuesit të medias, emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës, domethënë redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë, emri dhe adresë të shtypshkronjës dhe datën e botimit dhe ribotimit (shtypjes), si dhe numrin e kopjeve të shtypura, nëse kemi të bëjmë me medium të shtypit.

Agjencia, në kuadër të kompetencave të saj ligjore, nëpërmje Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, më 26 tetor 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative të subjektit të mbikëqyrjes, botuesit të medias së shtypit Shoqërisë për prodhim, qarkullim dhe shërbime (DPPU) REPRO PRINT SHPKNJP eksport-import Shkup, botues i "Nova Makedonija", ku konstatoi shkelje të nenit 14 paragrafi (1) të LM, të mënyrës që botuesi i medias së shkruar, në botimin (numrin) 25952 të "Nova Makedonija" të datës 20.10.2023, nuk e ka përmbushur plotësisht obligimin nga neni 14 paragrafi (1) nga LM, respektivisht në vend që të publikohet numri i saktë i kopjeve të shtypura, në impresium thuhet se botimi është shtypur "në tirazh deri në 3.500 kopje".

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.03-3865/1 datë 26.10.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar DPPU REPRO PRINT SHPKNJP eksport-import Shkup, botues i "Nova Makedonija" më 27.10.2023, ka dërguar Shkresë nr.y në PA1 nr.03-3865/2 datë 27.10.2023, me te cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.03-3865/1 datë 26.10.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga botuesi i medias së shkruar, më datë 02.11.2023, për të cilën në afatin e parashikuar DPPU REPRO PRINT SHPKNJP eksport-import Shkup ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM ark.nr.306-148/1 datë 06.11.2023 (nr ynë ark.03-3865/3 datë 07.11.2023). Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 11.11.2022 shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim dhe konkludoi që DPPU REPRO PRINT SHPKNJP eksport-import Shkup, t'i shqiptojë masën - vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 paragrafi (1) të LM, pika 3 nënparagrafi 2 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprimi sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.03-3865/1 datë 26.10.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LM, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 37-të mbajtur më 16.11.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-4225/6 datë 16.11.2023 ka marrë Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron DPPU REPRO PRINT SHPKNJP eksport-import Shkup, botues i "Nova Makedonija", dhe e obligon që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi botuesi i medias së shkruar ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit..

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrje e kryer administrative, ark.nr.03-3865/1 datë 26.10.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, botuesi i medias së shkruar ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.